

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Procesit Mësimor pranë Drejtorisë së Kurrikulave si më poshtë:

Kritere të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Përgjegjës i Sektorit të Procesit Mësimor

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në një nga fushat e arsimit të lartë.
- b) Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune.
- c) Të zotërojë një gjuhë të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Përgjegjës i Sektorit të Procesit Mësimor.

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1. Letër motivimi;
- 2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
- 3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- 4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
- 5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
- 6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
- 7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
- 9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **19.02.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.